

REZULTATET E VROJTIMIT TË
GJENDJES FINANCIARE DHE
HUAMARRËSE TË NDËRMARRJEVE
BUJQËSORE NË SHQIPËRI
JANAR 2018

Elona Dushku
Kliti Ceca

36 (75) 2019

MATERIAL STUDIMOR



BANKE E SHQIPËRISË


REZULTATET E VROJTIMIT TË
GJENDJES FINANCIARE DHE
HUAMARRËSE TË NDËRMARRJEVE
BUJQËSORE NË SHQIPËRI
Janar 2018

Elona Dushku
Kliti Ceca

36 (75) 2019

MATERIAL STUDIMOR

BANKA E SHQIPËRISË



Elona Dushku

Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë, e-mail: edushku@bankofalbania.org

Kliti Ceca

Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë, e-mail: kceca@bankofalbania.org

Falenderime: Autorët falënderojnë kolegët e Departamentit të Stabilitetit Financiar dhe të Institutit për bashkëpunimin e frytshëm. Gjithashtu falënderojnë të gjithë pjesëmarrësit e Bankës së Shqipërisë në aktivitetet ku ky material është prezantuar për komentet, sugjerimet dhe diskutimet e tyre të vlefshme.

Shënim: Mendimet e shprehura në këtë material janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinione ose qëndrime të Bankës së Shqipërisë.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE	9
1. HYRJE	12
1.1 Anketa dhe qëllimi i saj	12
1.2 Metodologjia e zgjedhjes	13
2. REZULTATET E VROJTIMIT	14
2.1 Situata financiare e ndërmarrjeve bujqësore dhe pritshmëritë e tyre për gjashtëmujorin në vazhdim	14
2.2 Huaja dhe përdorimi i saj	18
2.3 Vlerësimi i marrëdhënies së ndërmarrjeve bujqësore me bankat dhe pritshmëritë e tyre për të ardhmen	27
SHTOJCA 1	33

PËRMBAJTJA E GRAFIKËVE

Grafik 1.	Shpërndarja e zgjedhjes sipas rretheve	14
Grafik 2.	Si kanë ndryshuar shitjet e përgjithshme në 6 muajt e parë të vitit 2017 dhe si priten të ndryshojnë në 6 muajt e ardhshëm	15
Grafik 3.	Si ka ndryshuar rezultati financiar i ndërmarrjeve bujqësore në 6 muajt e parë të vitit 2017 dhe si priten të ndryshojnë në 6 muajt e ardhshëm	16
Grafik 4.	Si kanë ndryshuar veprimtaria apo investimet e ndërmarrjeve bujqësore në 6 muajt e parë të vitit 2017 dhe si priten të ndryshojnë në 6 muajt e ardhshëm	16
Grafik 5.	Vlerësimi i pengesave kryesore të ndërmarrjeve bujqësore gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2017	18
Grafik 6.	Burimet kryesore të financimit	18
Grafik 7.	Përqindja e ndërmarrjeve që kanë ose jo një hua	19
Grafik 8.	Periudha e marrjes së huasë	19
Grafik 9.	Burimi i fondeve të huasë së marrë	20
Grafik 10.	Cili është qëllimi i përdorimit të huasë?	20
Grafik 11.	Si konsiderohet huaja e marrë nga ndërmarrjet që e kanë marrë atë?	21
Grafik 12.	Koha e mbetur për të shlyer të gjithë vlerën e huasë	22
Grafik 13.	Përcaktimi i normës së interesit në kontratën e huasë	22
Grafik 14.	Frekuenca kohore e shlyerjes së huasë	23
Grafik 15.	Kolaterali i vendosur për marrjen e huasë	23
Grafik 16.	Vlera totale e kolateralit në raport me totalin e huasë	24
Grafik 17.	Barra e huasë ndaj totalit të të ardhurave	25
Grafik 18.	Ndryshimi i pagesës së huasë brenda 6-mujorit të parë 2017	25
Grafik 19.	Përballimi i kostos më të lartë të shërbimit të huasë nga ana e ndërmarrjeve bujqësore	26
Grafik 20.	Pritshmëritë mbi pagesën totale të këstit të huasë	26
Grafik 21.	Vlerësimi nga ana e ndërmarrjeve për ngarkesën e borxhit	27
Grafik 22.	Përqindjet e ndërmarrjeve mbi aplikimin apo jo të ndonjë forme financimi gjatë gjashtëmuajorit të parë 2017	27
Grafik 23.	Përqindjet e ndërmarrjeve që kanë aplikuar dhe u është (ose jo) miratuar financimi, si dhe lloji i financimit që kanë marrë	28
Grafik 24.	Përqindje e ndërmarrjeve që nuk u është miratuar kërkesa për financim si dhe arsyet e mosplotësimit të kushteve të bankës	29
Grafik 25.	Arsyet kryesore për mosaplikim për financim	29
Grafik 26.	Veprimet që do të kryenin ndërmarrjet nëse nuk do të financoheshin nga bankat	30

<i>Grafik 27. Vlerësimi i procesit të marrjes së huasë nga ndërmarrjet</i>	31
<i>Grafik 28. Perceptimi i ndërmarrjeve mbi marrëdhënien me bankat</i>	31
<i>Grafik 29. Mundësia që ndërmarrja të mund të marrë një kredi bankare në 6 muajt e ardhshëm</i>	32
<i>Grafik 30. Rëndësia e marrëdhënieve të bankës me ecurinë e veprimtarisë së ndërmarrjeve</i>	32

PËRMBLEDHJE

Sektori bujqësor ka qenë dhe vazhdon të mbetet një sektor me kontribut të konsiderueshëm në ekonominë shqiptare, si në terma të vlerës së shtuar, ashtu edhe në terma të numrit të të punësuarve. Duke marrë në konsideratë rëndësinë dhe rolin e tij në ekonomi, vëmendja ndaj këtij sektori dhe zhvillimi i tij ka qenë dhe vazhdon të mbetet prioritet si për sektorin privat, ashtu edhe për sektorin publik.

Prandaj, analiza dhe vlerësimi i situatës financiare e huamarrëse të ndërmarrjeve bujqësore në Shqipëri paraqet një interes të veçantë. Një faktor mjaft i rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të ndërmarrjeve është aksesin në financim dhe gjetja e fondeve të lira për zgjerimin e aktivitetit dhe rritjen e investimeve. Sektorët e tjerë të ekonomisë në Shqipëri e kanë pasur më të lehtë financimin e aktivitetit të tyre dhe marrjen më të shpejtë të një huaje përkundrejt sektorit bujqësor, pavarësisht kontributit të tij në ekonomi. Kjo ka ardhur për shkak të problemeve të ndryshme strukturore që ka ky sektor, si për shembull e drejta e pronës, gjetja e tregut, konkurrenca, cilësia dhe standardet e produkteve të ofruara etj.

Në këtë drejtim, Banka e Shqipërisë, në fillim të vitit 2017, ndërmori nismën për të analizuar ndërmarrjet bujqësore, kryesisht aksesin e tyre në financim, problemet që evidentohen nga ky sektor, si dhe vlerësimin e tyre mbi huanë, koston, barrën e huasë dhe të marrëdhënieve që ndërmarrjet bujqësore kanë me bankat. Vlerësimi i gjendjes financiare dhe situatës huamarrëse që ka ky sektor, jo vetëm që do të plotësojë informacionin për të gjithë sektorët e ekonomisë, që aktualisht mbulohen nga Vrojtimi mbi Gjendjen Financiare dhe Huamarrjen e ndërmarrjeve në Shqipëri¹, por edhe do të ndihmojë në identifikimin e vështirësive, perceptimin e problemeve që ka ky sektor, si dhe në dizajnimin e politikave të nevojshme me qëllim rritjen e aksesit financiar dhe zhvillimin e mëtejshëm të tij.

¹ Për më shumë referojuni rubrikës botime/vrojtime në faqen e Bankës së Shqipërisë. https://www.bankofalbania.org/Botime/Vrojtime/Vrojtim_mbi_Gjendjen_Financiare_dhe_Huamarrjen_e_Ndermarrjeve_ne_Shqiperi/

Rezultatet e përmbledhura të Vrojtimimit mbi Gjendjen Financiare dhe Huamarrëse të ndërmarrjeve bujqësore të kryer në qershor të vitit 2017, kanë evidentuar zhvillimet e mëposhtme:

Gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2017, ndërmarrjet bujqësore pohojnë se **përgjithësisht shitjet dhe rezultati financiar i ndërmarrjeve bujqësore ka mbetur i pandryshuar** ose ka rënë në krahasim me atë të një gjashtëmuajori më parë.

Rreth 40% e ndërmarrjeve bujqësore presin rritje të shitjeve dhe të rezultatit financiar gjatë gjashtëmuajorit të dytë 2017.

Përsa i përket zgjerimit të aktivitetit apo investimeve, **pjesa më e madhe e ndërmarrjeve bujqësore (79% e tyre) pohojnë që as nuk e kanë zgjeruar aktivitetin gjatë gjashtëmuajorit të parë 2017 dhe as nuk do ta ndryshojnë aktivitetin apo investimet gjatë gjashtëmuajorit të dytë 2017.**

Problemet kryesore të identifikuar nga ndërmarrjet bujqësore gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2017 për veprimtarinë e tyre janë: problemet e lidhura me specifikën e sektorit, gjetja e tregut, konkurrenca dhe kostoja e financimit.

Burimi kryesor i financimit të ndërmarrjeve bujqësore janë shitjet dhe fondet e veta, ndërsa huaja është fare e papërfillshme.

Vetëm 18% e ndërmarrjeve bujqësore kanë një hua për të paguar, ndërsa 82% e tyre raportojnë se nuk kanë.

Ndërmarrjet bujqësore që kanë marrë hua shprehen se kryesisht e kanë marrë nga bankat, nga persona fizikë dhe nga institucione financiare jobanka.

Huaja e marrë është përdorur më së shumti për të përballuar shpenzimet korrente të tyre (73% e ndërmarrjeve) dhe 46% janë shprehur se e kanë përdorur huanë për të bërë një investim afatgjatë.

57% e ndërmarrjeve bujqësore që kanë marrë hua, shprehen se kanë vendosur një kolateral për huanë e marrë, ndërsa 35% pohojnë se nuk kanë vendosur një kolateral.

Ndërmarrjet që kanë vendosur apo kanë lënë si garanci një pasuri të paluajtshme, pohojnë se vlera e kolateralit (për 52% të ndërmarrjeve) është sa gjysma e vlerës së huasë.

Barra e huasë (për 51% të ndërmarrjeve) është sa 20-50% e totalit të të ardhurave, ndërsa për 40% të ndërmarrjeve luhatet nën nivelin e 20% të të ardhurave. Vetëm 2% e ndërmarrjeve shprehen se barra e huasë është mbi 80% të nivelit të të ardhurave. Përgjithësisht ndërmarrjet vlerësojnë se barra e huasë është e shtrenjtë.

92% e ndërmarrjeve bujqësore nuk aplikojnë për të marrë një kredi në bankë, pasi nuk e kanë të nevojshme për veprimtarinë e tyre (41% e ndërmarrjeve), u duket proces i vështirë (32% e ndërmarrjeve), si dhe e kanë më të lehtë të marrin hua nga burime alternative (21% e ndërmarrjeve).

Megjithatë rreth 64% e totalit të ndërmarrjeve e konsiderojnë të domosdoshme dhe të rëndësishme marrëdhënien me bankat për ecurinë e veprimtarisë së tyre.

1. HYRJE

1.1 ANKETA DHE QËLLIMI I SAJ

Vrojtimi mbi Gjendjen Financiare dhe Huamarrëse të ndërmarrjeve bujqësore ka për qëllim që të marrë informacion për herë të parë mbi situatën financiare dhe huamarrëse të këtyre ndërmarrjeve në Shqipëri. Fokusi dhe marrja e informacionit mbi ndërmarrjet bujqësore erdhi si një domosdoshmëri për të plotësuar informacionin që merret nga Vrojtimi² mbi Gjendjen Financiare dhe Huamarrëse të Ndërmarrjeve të Mëdha dhe të Mesme, zhvilluar nga Banka e Shqipërisë që prej vitit 2010, por që nuk shtrihet tek ndërmarrjet bujqësore. Për të ruajtur konsistencën e informacionit të marrë nga ndërmarrjet e mëdha, të mesme, si dhe ato mikro (1-4 të punësuar) kemi ruajtur të njëjtën formë të anketës në mënyrë që përgjigjet të jenë të krahasueshme dhe të plotësojnë informacionin e marrë për të gjitha ndërmarrjet në gjithë sektorët.

Anketa³ është e organizuar në katër rubrika kryesore. Rubrika e parë paraqet një informacion të përgjithshëm në lidhje me mënyrën e organizimit dhe sektorin ku kjo ndërmarrje vepron. Rubrika e dytë fokusohet në ecurinë financiare të ndërmarrjeve dhe sjelljen e tyre ndaj huasë. Në vazhdim rubrika e tretë dhe e katërt jep një pamje të përgjithshme për huatë që ndërmarrjet kanë marrë, llojin dhe kushtet e marrjes së huasë. Ndërsa në rubrikën e pestë pasqyrohet se si ndërmarrjet e perceptojnë marrëdhënien e tyre me bankat dhe rolin e tyre në ecurinë e aktivitetit të ndërmarrjeve bujqësore.

Arsyeja e anketimit të ndërmarrjeve bujqësore është se këto ndërmarrje nuk janë pjesë e zgjedhjes së vërtetimit aktual mbi ndërmarrjet e mëdha dhe të mesme, si dhe vërtetimit të ndërmarrjeve mikro. Për më tepër, sektori i bujqësisë është një sektor me rëndësi për ekonominë shqiptare, duke pasur në konsideratë kontributin që ai ka në terma të vlerës së shtuar dhe të punësuarve. Kështu me anë

² Për më shumë referojuni Vrojtimin mbi Gjendjen Financiare dhe Huamarrjen e ndërmarrjeve në Shqipëri në faqen e Bankës së Shqipërisë.
https://www.bankofalbania.org/Botime/Vrojtime/Vrojtim_mbi_Gjendjen_Financiare_dhe_Huamarrjen_e_Ndermarrjeve_ne_Shqiperi/

³ Për detaje të mëtejshme të anketës, ju lutem referojuni shtojcës 1.

të këtij vrojtimi dhe rezultateve të marra prej tyre synojmë të krijojmë një vështrim të përgjithshëm mbi gjendjen financiare të ndërmarrjeve bujqësore, aksesit në financim të ndërmarrjeve bujqësore, situatës financiare si dhe marrëdhënies që kanë këto ndërmarrje me bankat.

Një faktor mjaft i rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të ndërmarrjeve është aksesit në financim dhe gjetja e fondeve të lira për zgjerimin e aktivitetit dhe rritjen e investimeve. Për më tepër Banka e Shqipërisë duke evidentuar rolin e sektorit bujqësor, si dhe për të pasur një vlerësim dhe analizë të plotë mbi sistemin financiar në tërësi, rritjen e mëtejshme të përfshirjes financiare dhe vlerësimin të vështirësive që përballen sektorët kryesorë të ekonomisë ndërmori këtë vërtetim, rezultatet e të cilët paraqiten në këtë raport.


Anketa mbi ndërmarrjet bujqësore u realizua në muajin qershor të vitit 2017 dhe pyetjet i referohen situatës së tyre financiare dhe asaj huamarrëse gjatë gjashtëmuajorit të parë 2017, si dhe pritshmëritë e tyre për gjashtëmuajorin e dytë 2017.

1.2 METODOLOGJIA E ZGJEDHJES

Procesi i zgjedhjes së ndërmarrjeve bujqësore dhe anketimi u administrua dhe u realizua nga INSTAT. Vëllimi i popullatës së konsideruar nga INSTAT në anketim është 31,487 ndërmarrje bujqësore. Mbi këtë popullatë u realizua zgjedhja prej 1,004 subjektësh që i korrespondon një niveli gabimi prej 2%. Gjatë realizimit të anketimit në terren, vetëm 841 ndërmarrje iu përgjigjën plotësisht të anketës, ndërsa pjesa tjetër rezultuan pa kontakt, pasive (e fjetur), të mbyllura (çregjistruar) ose refuzuan të përgjigjeshin.

Shpërndarja e zgjedhjes u krye sipas parimit të proporcionalitetit, duke ruajtur të njëjtën shpërndarje që ndërmarrjet bujqësore kanë në territorin e Shqipërisë. Të dhënat tregojnë që pjesa më e madhe e ndërmarrjeve bujqësore (rreth 75% e tyre) janë të vendosura kryesisht në zonën e Lushnjës, Beratit, Fierit, Elbasanit, Korçës, Shkodrës, Malësisë së Madhe, Durrësit, Lezhës, Devollit, Tiranës. Ndërsa një e katërta e ndërmarrjeve bujqësore në pjesën tjetër të Shqipërisë (Grafiku 1).

Grafiku 1. Shpërndarja e zgjedhjes sipas rretheve



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve bujqësore, qershor 2017.

Përpunimi i rezultateve u realizua duke përdorur peshat e përfaqësimit të zgjedhjes nga popullata, kështu që rezultatet e prezantuara vlejnë për të gjithë popullatën e ndërmarrjeve bujqësore.

2. REZULTATET E VROJTIMIT


Rezultatet e vrojtimit janë paraqitur në vazhdim, ku fillimisht paraqitet një përmbledhje mbi gjendjen financiare të ndërmarrjeve të vrojtuar. Pjesa e dytë pasqyron situatën në lidhje me huanë dhe kushtet e përcaktimit të saj, ndërsa në fund trajtohen rezultatet mbi perceptimin që kanë ndërmarrjet bujqësore për marrëdhënien e tyre me bankat dhe elementet që ndikojnë në këtë marrëdhënie.

2.1 SITUATA FINANCIARE E NDËRMARRJEVE BUJQËSORE DHE PRITSHMËRITË E TYRE PËR GJASHTËMUJORIN NË VAZHDIM

Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve bujqësore u realizua gjatë muajit qershor të vitit 2017 dhe kishte

për qëllim mbledhjen e informacionit mbi situatën financiare të këtyre ndërmarrjeve gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2017, si dhe mbi pritshmëritë e tyre për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2017.


Të pyetur në lidhje me ecurinë e shitjeve gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2017, 43% e ndërmarrjeve bujqësore pohojnë se shitjet e tyre nuk kanë ndryshuar gjatë kësaj periudhe dhe 40% e ndërmarrjeve shprehen se shitjet e tyre kanë rënë (Grafiku 2). Ndërsa 16% e ndërmarrjeve bujqësore pohojnë se shitjet e tyre janë rritur në këtë gjashtëmujor. Për sa i përket pritshmërive për gjashtëmujorin e dytë 2017 (Grafiku 2, kolona e dytë), 44% e ndërmarrjeve bujqësore presin rritje të shitjeve, 38% e ndërmarrjeve pohojnë se shitjet nuk do të ndryshojnë dhe vetëm 19% presin rënie të tyre.



Në lidhje me rezultatin financiar, 48% e ndërmarrjeve bujqësore pohojnë se gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2017, ai ka mbetur i pandryshuar, 37% e ndërmarrjeve pohojnë se rezultati financiar ka rënë. Kurse 15% e ndërmarrjeve bujqësore pohojnë se rezultati financiar i tyre është rritur gjatë gjashtëmujorit të parë 2017 (Grafiku 3). Ndërmarrjet duken optimiste për gjashtëmujorin e dytë 2017, ku 42% e ndërmarrjeve presin rritje të rezultatit financiar, ndërsa 39% e tyre presin që rezultati financiar të mbetet të paktën i pandryshuar (Grafiku 3, kolona e dytë). Vetëm 19% e ndërmarrjeve

bujqësore presin rënie të rezultatit financiar gjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2017.

Grafik 3. Si ka ndryshuar rezultati financiar i ndërmarrjeve bujqësore në 6 muajt e parë të vitit 2017 dhe si priten të ndryshojnë në 6 muajt e ardhshëm*




Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve bujqësore, qershor 2017.
Kolona e parë përfaqëson përgjigjet mbi rezultatin financiar në 6 muajt e parë të vitit 2017, ndërsa kolona e dytë paraqet pritshmëritë e ndërmarrjeve për rezultatin financiar në 6 muajt e ardhshëm.

*Shënim: Ndërmarrjet janë pyetur se si ka ndryshuar rezultati financiar në 6 muajt e fundit, si dhe si presin të ndryshojnë në 6 muajt e ardhshëm: (rretho vetëm 1 alternativë) 1. Janë rritur (Do të rriten); 2. Janë ulur, (Do të ulet); 3. Nuk kanë ndryshuar (Nuk do të ndryshojnë).

Për sa i përket zgjerimit apo jo të aktivitetit (apo të investimeve), mesatarisht 78% e ndërmarrjeve bujqësore pohojnë se nuk e kanë ndryshuar aktivitetin gjatë gjashtëmuajorit të parë dhe presin që të mos ketë ndryshime as gjatë gjashtëmuajorit të dytë 2017 (Grafiku 4).


Grafik 4. Si kanë ndryshuar veprimtaria* apo investimet e ndërmarrjeve bujqësore në 6 muajt e parë të vitit 2017 dhe si priten të ndryshojnë në 6 muajt e ardhshëm



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve bujqësore, qershor 2017.
Shënim: Ndërmarrjet janë pyetur nëse kanë ndryshuar apo jo veprimtarinë apo investimet në 6 muajt e fundit, si dhe si presin të ndryshojnë në 6 muajt e ardhshëm: (rretho vetëm 1 alternativë) 1. Është zgjeruar (Do të zgjerohet); 2. Është ngushtuar (Do të ulet); 3. Nuk kanë ndryshuar (Nuk do të ndryshojnë).
Kolona e parë përfaqëson përgjigjet për veprimtarinë (apo investimet) në 6 muajt e parë të vitit 2017, ndërsa kolona e dytë përfaqëson përgjigjet për veprimtarinë (apo investimet) në 6 muajt e ardhshëm.

Për të evidentuar problematikën kryesore në aktivitetin e tyre për gjashtëmujorin për të cilin është kryer vërtetimi, subjekteve bujqësore iu kërkua të klasifikojnë vështirësitë që ato kanë hasur lidhur me disa tipare që janë: aksesin në financim, kostojat e financimit, disponueshmëria e stafit të kualifikuar, kostojat e prodhimit ose e punës, konkurrenca, gjetja e tregut, përshtatshmëria e legjislatcionit në fuqi apo të tjera veç këtyre. Subjektet vlerësuan me notat nga një (shkalla më e ulët e vështirësisë) deri në dhjetë (shkalla më e lartë e vështirësisë) problemet e sipërpërmendura.


Ndërmarrjet bujqësore evidentojnë se faktorë të tjerë⁴, gjetja e tregut, konkurrenca dhe kostojat e financimit janë ndër problemet kryesore me të cilat ato janë përballur kryesisht gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2017 (Grafiku 5). Rezultatet e vërtimit të paraqitura në grafik tregojnë që aksesin dhe kostojat e financimit janë gjithashtu një pengesë e rëndësishme e vlerësuar nga ana e tyre.



Të pyetur mbi burimet kryesore të financimit, ndërmarrjet bujqësore janë shprehur se 64% e tyre kanë përdorur shitjet për të financuar

⁴ Ku tek faktorë të tjerë, ndërmarrjet bujqësore evidentojnë: amortizimi i rrugëve, lënda e parë si farat dhe plehurat e shtrenjta ose të skaduara, çmime të ulëta për produktet bujqësore, dalja me vonesë në treg, karburanti i shtrenjtë, mungesa e subvencioneve, mospagesa nga subjektet etj.


veprimtarinë e biznesit gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2017 dhe 30% e ndërmarrjeve kanë përdorur rezervat e mbartura. Ndërsa huaja përdoret si burim financimi nga vetëm 5% e ndërmarrjeve bujqësore, që tregon për një ndërmjetësim të ulët financiar ndaj këtij sektori (Grafiku 6).



2.2 HUAJA DHE PËRDORIMI I SAJ


Ndërmarrjet bujqësore u pyetën në lidhje me huanë dhe përdorimin e saj prej tyre. Të dhënat e marra nga vërtetimi tregojnë se vetëm 18% e ndërmarrjeve bujqësore kanë aktualisht një hua, ndërsa 82% e tyre pohojnë se nuk kanë (Grafiku 7). Të pyetur mbi kohën e marrjes së huasë, 44% e ndërmarrjeve bujqësore pohojnë se e kanë marrë atë kryesisht gjatë pesëvjeçarit të fundit, që i korrespondon viteve 2012-2017, 36% e kanë marrë gjatë vitit të fundit dhe 24% e kanë marrë huanë në 6 muajt e fundit (Grafiku 8). Ndërsa para vitit 2012, kanë marrë hua një numër shumë i vogël ndërmarrjesh bujqësore, vetëm 3%.

Grafik 7. Përqindja e ndërmarrjeve që kanë ose jo një hua.



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve bujqësore, qershor 2017.
Shënim: Pyetja që u drejtohet ndërmarrjeve është: A keni aktualisht hua për të paguar? (Rretho vetëm një alternativë: 1. Po; 2.)


Grafik 8. Periudha e marrjes së huasë



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve bujqësore, qershor 2017.
Shënim: Pyetja që u drejtohet ndërmarrjeve është: Kur e keni marrë huanë? (1. Në gjashtë muajt e fundit, 2. Vitin e fundit, 3. 1-5 vitet e fundit, 4. Para më shumë se 5 vitesh, mund të zgjidhet më shumë se një alternativë).

Në vazhdimësi, ndërmarrjet që kanë marrë një hua janë pyetur se ku e kanë marrë huanë, si dhe me çfarë kushtesh e kanë marrë atë. Të dhënat e paraqitura në grafikët e mëposhtëm tregojnë se ndërmarrjet bujqësore kanë marrë hua kryesisht nga bankat, (65% e ndërmarrjeve) dhe nga personat fizikë (23% e ndërmarrjeve). Ndërsa burimet e tjera të financimit, përdoren më pak nga ndërmarrjet bujqësore për të financiar veprimtarinë e tyre (Grafiku 9).


Grafik 9. Burimi i fondeve të huasë së marrë



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve bujqësore, qershor 2017.
Shënim: Ndërmarrjeve që kanë marrë hua, u është drejtuar pyetja: Nga e keni marrë huanë? (mund të zgjidhni një ose më shumë alternative).


Të pyetur mbi qëllimin e përdorimit të huasë, pjesa më e madhe e ndërmarrjeve bujqësore pohojnë se e kanë marrë huanë kryesisht për të përballuar shpenzimet korrente (73%), si dhe për të kryer një investim afatgjatë (46%). Ndërsa për të shlyer një hua të vjetër dhe për arsye të tjera përdoret relativisht pak (përkatesisht nga 9% dhe 2% e ndërmarrjeve bujqësore, Grafiku 10).

Grafik 10. Cili është qëllimi i përdorimit të huasë?



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve bujqësore, qershor 2017.
Shënim: Ndërmarrjeve bujqësore që kanë marrë hua u është drejtuar pyetja: Cili është qëllimi i përdorimit të huasë? (zgjidh më shumë se një alternativë). Përgjigjet janë dhënë në përqindje ndaj totalit të ndërmarrjeve që janë shprehur se kanë aktualisht një hua për të paguar.


Ndërmarrjet bujqësore, të cilat kanë marrë një hua për të financuar veprimtarinë e tyre janë pyetur për të dhënë një vlerësim mbi huanë që kanë marrë. Rezultatet tregojnë që 41% e ndërmarrjeve bujqësore që kanë marrë një hua, deklarojnë se huaja e marrë është e përshtatshme, 31% e ndërmarrjeve deklarojnë se do të donin të merrnin më shumë dhe 28% e tyre deklarojnë se do të donin të merrnin më pak (Grafiku 11).



Të pyetur mbi kohën e shlyerjes së huasë, vërehet se pjesa më e madhe e huasë është marrë me afat të shkurtër maturimi, kështu 68% e huasë pritet të shlyhet brenda tre viteve të ardhshme, 22% e huasë pritet të shlyhet nga tre deri në pesë vitet e ardhshme dhe 10% e huasë do të shlyhet mbas dhjetë vjetësh (Grafiku 12).


Të pyetur mbi mënyrën e përcaktimit të normës së interesit të huasë, 95% e ndërmarrjeve bujqësore që kanë marrë një hua, pohojnë se norma e interesit të saj do të mbetet e pandryshuar deri në fund të afatit të maturimit të huasë (Grafiku 13). Një pjesë e vogël e ndërmarrjeve bujqësore pohojnë që norma e interesit të huasë është e luhatshme që mund të ndryshojë çdo 3, 6 apo 12 muaj.

Grafik 12. Koha e mbetur për të shlyer të gjithë vlerën e huasë



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve bujqësore, qershor 2017.
Shënim: Ndërmarrjet janë pyetur: Edhe sa kohë duhet për të shlyer të gjithë vlerën e huasë (afati maksimal - rretho vetëm një): 1. deri në 6 muaj, 2. 6-12 muaj, 3. 1-3 vjet, 4. 3-5 vjet, 5. mbi 5 vjet.


Grafik 13. Përcaktimi i normës së interesit në kontratën e huasë



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve bujqësore, qershor 2017.
Shënim: Ndërmarrjet janë pyetur se si është përcaktuar norma e interesit e të huasë më të madhe ekzistuese? (rretho vetëm një alternativë): 1. E pandryshueshme deri në fund të afatit, 2. Mund të ndryshojë çdo 3 muaj; 3. Mund të ndryshojë çdo 6 muaj; 4. Mund të ndryshojë çdo vit; 5. Tjetër.

Në lidhje me kohën e shlyerjes së huasë, gjysma e ndërmarrjeve bujqësore raportojnë që e shlyejnë atë çdo muaj, ndërsa pjesa e mbetur çdo tre, gjashtë dhe dymbëdhjetë muaj (Grafiku 14).


Grafik 14. Frekuenca kohore e shlyerjes së huasë



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve bujqësore, qershor 2017.
 Shënim: Sa shpesh e shlyeni huasë? (rretho vetëm një alternativë, 1. Çdo 1 muaj, 2. Çdo 3 muaj, 3. Çdo 6 muaj, 4. Çdo 12 muaj, 5. Tjetër).


Ndërmarrjet bujqësore, të cilat kanë marrë një hua, raportojnë se 52% e tyre kanë vendosur apo kanë lënë si kolateral (garanci) një pasuri të patundshme, ndërsa 35% e ndërmarrjeve pohojnë që nuk kanë vendosur kolateral. Vendosja e dorëzanisë apo e mjeteve të tjera financiare është përdorur si kolateral përkatësisht nga 11% dhe 7% e ndërmarrjeve bujqësore (Grafiku 15).

Grafik 15. Kolaterali i vendosur për marrjen e huasë



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve bujqësore, qershor 2017.
 Shënim: Ndërmarrjet u pyetën: cili është kolaterali që keni vendosur për përfitim të huasë? (mund të rrethohen më shumë se një alternativë: Nuk ka, Pasuri e paluajtshme, Mjete financiare, Dorëzani, Mjete financiare, Të tjera [makineri, pajisje]).


52% e ndërmarrjeve bujqësore, të cilat kanë marrë një hua, pohojnë se vlera e kolateralit të tyre është nën 50% të vlerës së huasë dhe 22% e ndërmarrjeve bujqësore pohojnë se kolaterali është sa 50-100% të vlerës së huasë. Ndërsa vetëm për 26% të ndërmarrjeve, vlera e kolateralit të vendosur tejkalon mbi 100% vlerën e huasë (Grafiku 16).



Barra e huasë për 51% të ndërmarrjeve bujqësore është brenda intervalit 20 deri 50% të totalit të ardhurave, për 40% e ndërmarrjeve luhetet në nivelin e 20% të të ardhurave, që tregon se barra e huasë është relativisht e shtrenjtë për këto ndërmarrjeve. Kurse për 10% e ndërmarrjeve, barra e huasë është në intervalin 50 deri në mbi 80% të të ardhurave totale të ndërmarrjeve, që tregon që për këto ndërmarrje barra e huasë është shumë e kushtueshme (Grafiku 17).


91% e ndërmarrjeve bujqësore pohojnë se pagesa e huasë nuk ka ndryshuar gjatë 6 muajve të parë të vitit 2017 (Grafiku 18). Vetëm për 9% të ndërmarrjeve pagesa e huasë gjatë 6-mujorit të parë 2017 është rritur, ardhur kryesisht nga rënia e të ardhurave të siguruar nga biznesi, si dhe nga kërkesat e shtuara të huadhënësve.

Grafik 17. Barra e huasë ndaj totalit të të ardhurave



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve bujqësore, qershor 2017.
 Shënim: Ndërmarrjet u pyetën se sa kanë paguar për huanië ndaj totalit të të ardhurave në 6 muajt e kaluar?
 (rretho vetëm 1 një alternativë): 1. Deri në 20% të të ardhurave; 2. 20-50% të të ardhurave,
 3. 50-80% të të ardhurave; 4. Mbi 80% të të ardhurave.


Grafiku 18. Ndryshimi i pagesës së huasë brenda 6-mujorit të parë të 2017



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve bujqësore, qershor 2017.
 Shënim: Ndërmarrjet janë pyetur nëse kanë ndryshuar shpenzimet për pagesën e huasë gjatë 6 muajve të parë të
 2017, cili ka qenë shkaku?

Për të përballuar koston e rritur të huasë, ndërmarrjet bujqësore janë shprehur më së shumti se kanë ulur shpenzimet e tjera, si dhe kanë përdorur rezervat e ndryshme që kanë pasur (Grafiku 19).


Grafik 19. Përballimi i kostos më të lartë të shërbimit të huasë nga ana e ndërmarrjeve bujqësore



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve bujqësore, qershor 2017.
 Shënim: Ndërmarrjet janë pyetur nëse kosto e shërbimit të huasë është rritur, si keni vepruar për ta përbaluar rritjen?
 (mund të rrethohet më shumë se një alternativë: 1. Janë rritur çmimet e produkteve që iu shiten klientëve; 2. Është shitur një pjesë e veprimtarisë së ndërmarrjes; 3. Janë ulur shpenzimet e tjera; 4. Janë përdorur rezerva të ndryshme; 5. Është orientuar veprimtaria e ndërmarrjes drejt një fushë veprimi më fitimprurëse; 6. Tjetër.)


Pritjet e ndërmarrjeve bujqësore për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2017, tregojnë se 88% e ndërmarrjeve nuk presin që pagesa totale e këstit të huasë të ndryshojë (Grafiku 20). Për më tepër ndërmarrjet janë pyetur të vlerësojnë ngarkesën e borxhit, duke zgjedhur njërën nga alternativat: e lartë, e mesme apo e ulët. 58% e ndërmarrjeve bujqësore e vlerësojnë ngarkesën e borxhit të lartë, 39% e vlerësojnë mesatare dhe vetëm 3% e vlerësojnë ngarkesën e borxhit të ulët (Grafiku 21).

Grafik 20. Pritshmëritë mbi pagesën totale të këstit të huasë



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve bujqësore, qershor 2017.
 Shënim: Ndërmarrjet janë pyetur se si presin që të ndryshojë pagesa totale e këstit të kredisë në 6 muajt e ardhshëm?
 (rretho vetëm një alternativë, 1. Nuk do të ndryshojë; 2. Do të rritet; 3. Do të ulët.)

Grafik 21. Vlerësimi nga ana e ndërmarrjeve për ngarkesën e borxhit




Burimi: Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve bujqësore, qershor 2017.
 Shënim: Ndërmarrjet janë pyetur se si e vlerësojnë në përgjithësi ngarkesën e borxhit? (Iretho vetëm 1 alternativë,
 1. E lartë; 2. Mesatare; 3. E ulët.

2.3 VLERËSIMI I MARRËDHËNIES SË NDËRMARRJEVE BUJQËSORE ME BANKAT DHE PRITSHMËRITË E TYRE PËR TË ARDHMEN

Në këtë pjesë vlerësohet se si ndërmarrjet bujqësore e kanë perceptuar marrëdhënien e tyre me bankat gjatë gjashtëmujorit të


Grafik 22. Përqindjet e ndërmarrjeve mbi aplikimin apo jo të ndonjë forme financimi gjatë gjashtëmujorit të parë 2017



Burimi: Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve bujqësore, qershor 2017.
 Shënim: A keni aplikuar për ndonjë formë financimi në gjashtëmujorin e parë 2017? (Zgjidh vetëm 1 alternativë,
 1. Po kam aplikuar, 2. Jo nuk kam aplikuar).


parë të vitit 2017, si dhe pritshmëritë e tyre për gjashtëmujorin në vazhdim. Rezultatet e marra tregojnë që vetëm 8% e ndërmarrjeve bujqësore kanë aplikuar për ndonjë formë financimi gjatë gjashtëmujorit të parë 2017, përkundrejt 92% të ndërmarrjeve që nuk kanë aplikuar (Grafiku 22).

Ndërmarrjet të cilat kanë kërkuar financim në gjashtëmujorin e parë të vitit 2017, janë pyetur nëse është miratuar apo jo kërkesa për financim, si dhe në rastet kur kjo kërkesë është miratuar, cili ka qenë objekti i financimit. Ndërmarrjet raportojnë se 66% e rasteve të aplikimit për financim nuk janë miratuar. Gjithsej gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2017 janë miratuar vetëm 34% të rasteve, nga të cilat 74% kanë marrë një hua të re dhe 26% e ndërmarrjeve kanë ristrukturuar huanë ekzistuese (Grafiku 23).



Ndërmarrjeve që nuk u është miratuar kërkesa pyeten nëse kërkesa është refuzuar plotësisht apo është në proces. 70% e ndërmarrjeve që nuk u është miratuar kërkesa pohojnë që refuzimi ka ardhur pasi nuk plotësoheshin kushtet e bankës, ndërsa për 30% të ndërmarrjeve kërkesa është në proces (Grafiku 24).


Grafik 24. Përqindje e ndërmarrjeve që nuk u është miratuar kërkesa për financim si dhe arsyet e mosplotësimit të kushteve të bankës



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve bujqësore, Qershor 2017.
 Shënim: Ndërmarrjet bujqësore që nuk u është miratuar kërkesa për financim, janë pyetur nëse kërkesa është në proces apo është refuzuar plotësisht, si dhe në rastet e refuzimit, cilat janë arsyet e mosplotësimit të kushteve nga ana e bankës.


Ndër arsyet kryesore të mosaplikimit për financim, ndërmarrjet bujqësore shprehen që nuk e kanë të nevojshme për veprimtarinë e tyre (41% e ndërmarrjeve), si dhe u duket proces i vështirë (32% e ndërmarrjeve). Nga ana tjetër, 21% e ndërmarrjeve bujqësore pohojnë se e kanë më të lehtë për të marrë hua nga burime alternative dhe 6% e ndërmarrjeve mendojnë që kërkesa e tyre nuk miratohet (Grafiku 25).

Grafik 25. Arsyet kryesore për mosaplikim për financim



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve bujqësore, qershor 2017.
 Shënim: Ndërmarrjet që nuk kanë aplikuar, janë pyetur se cilat janë arsyet e mosaplikimit? (duke zgjedhur alternativën e mëposhtme: Nuk e kam të nevojshme për veprimtarinë që kryej; Më duket proces i vështirë; Mendoj që kërkesa ime nuk miratohet; E kam më të lehtë të marr hua nga burime alternative).


Të pyetur se si do të vepronin nëse nuk do të financoheshin nga bankat, 60% e ndërmarrjeve kanë pohuar se do të merrnin hua nga burime alternative, 25% e ndërmarrjeve shprehën se do të shtyjnë në kohë planet për zgjerim të veprimtarisë dhe 14% e ndërmarrjeve pohojnë se mendojnë të kërkojnë hua në një bankë apo institucion tjetër (Grafiku 26).



Përgjithësisht ndërmarrjet bujqësore vlerësojnë se procesi i marrjes së një huaje nga bankat është i vështirë ose shumë i vështirë raportuar nga 67% e ndërmarrjeve, ndërsa 4% e tyre e gjykojnë pothuajse të pamundur këtë proces. Nga ana tjetër, vetëm 29% e ndërmarrjeve bujqësore e vlerësojnë procesin e marrjes së huasë shumë të thjeshtë dhe normal (Grafiku 27).

Gjithashtu ndërmarrjet bujqësore u pyetën të vlerësojmë nga 1 deri në 5, vështirësitë që paraqet secili element në marrëdhënien e bankës me ndërmarrjet bujqësore. Rezultatet e marra nga vrojtimi treguan që vështirësia e marrëdhënies së ndërmarrjeve bujqësore me bankat qëndron në faktin se në perceptimin e tyre kredia në përgjithësi është e shtrenjtë, ka kosto të lartë financiare për të plotësuar kërkesat e bankës, si dhe struktura e kredisë nuk i përshtatet ciklit të veprimtarisë së biznesit të ndërmarrjeve bujqësore (Grafiku 28).


Grafik 27. Vlerësimi i procesit të marrjes së huasë nga ndërmarrjet



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve bujqësore, qershor 2017.

Shënim: Ndërmarrjet janë pyetur se si e vlerësonin procesin e marrjes së një huaje nga bankat në vend në këto 6 muajt e fundit duke rrethuar vetëm një përgjigje: 1. Shumë të thjeshtë; 2. Normal; 3. Të vështirë; 4. Shumë të vështirë; 5. Pothuaj të pamundur.

Grafik 28. Perceptimi i ndërmarrjeve mbi marrëdhënien me bankat




Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve bujqësore, qershor 2017.

Shënim: Ndërmarrjet pyeten mbi se cili element paraqet vështirësi për ndërmarrjen tuaj në përfitimin e një kredie bankare (nga 1 deri në 5, nga shkalla më e ulët tek shkalla më e lartë e vështirësisë, për secilën alternativë më sipër).

Të pyetur mbi mundësinë e tyre për të marrë një kredi bankare në 6 muajt e ardhshëm, 52% ndërmarrjeve bujqësore pohojnë se nuk ka asnjë mundësi për të marrë kredi dhe 42% e ndërmarrjeve vlerësojnë se ka pak mundësi. Vetëm 15% e ndërmarrjeve bujqësore, vlerësojnë se ka shumë mundësi (5%) dhe se është e sigurt (10%) që do të marrin kredi në gjashtëmuajorin e dytë 2017 (Grafiku 29).


Grafik 29. Mundësia që ndërmarrja të mund të marrë një kredi bankare në 6 muajt e ardhshëm



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve bujqësore, qershor 2017.
 Shënim: Ndërmarrjet janë pyetur se sa është mundësia që ndërmarrja juaj të marrë një kredi bankare në 6 muajt e ardhshëm (duke zgjedhur vetëm një alternativë; 1. Nuk ka asnjë mundësi; 2. Ka pak mundësi; 3. Ka shumë mundësi; 4. Është e sigurt).

Nga ana tjetër, pavarësisht perceptimit të tyre se kredia bankare është e shtrenjtë, ndërmarrjet bujqësore i vlerësojnë të rëndësishme dhe të domosdoshme bankat për ecurinë e veprimtarisë së tyre (Grafiku 30). Megjithatë një pjesë e konsiderueshme, rreth një e treta e ndërmarrjeve bujqësore gjykojnë se marrëdhënia e tyre me bankën nuk është dhe aq e rëndësishme (Grafiku 30).

Grafiku 30. Rëndësia e marrëdhënieve të bankës me ecurinë e veprimtarisë së ndërmarrjeve



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve bujqësore, qershor 2017.
 Shënim: Ndërmarrjet janë pyetur sa të rëndësishme i konsiderojnë marrëdhëniet me bankat për ecurinë e veprimtarisë së kompanisë suaj? (rretho vetëm 1 alternativë: 1. Të domosdoshme; 2. Të rëndësishme, 3. Jo dhe aq të rëndësishme.)

SHTOJCA 1

PYETËSOR MBI GJENDJEN FINANCIARE DHE HUAMARRJEN E NDËRMARRJEVE BËGËSORE

Indikatori i përgjigjes 1. përgjigjur 2. refuzim 3. pa kontakt 4. pasive (fjetur) 5. mbyllur (çregjistruar) 6. jashtë qëllimit

RUBRIKA I: ORGANIZIMI I NDËRMARRJES

**P1. Sa % të produkteve tuaja shiten brenda vendit?
(rretho vetëm një)**

1. Deri në 20%;
2. 20-50%;
3. 50-80%;
4. Mbi 80%.

P2. Sa të rëndësishme kanë qenë problemet e mëposhtme në gjashëmujorin e kaluar për ndërmarrjen tuaj, ku 1- shkalla më e ulët e vështirësisë dhe 10- shkalla më e lartë e vështirësisë. (Plotëso secilën alternativë):

1. Aksesi në financim_____
2. Kosto e financimit _____
3. Disponueshmëria e stafit të kualifikuar_____
4. Kosto e prodhimit ose e punës____
5. Konkurrenca _____
6. Gjetja e tregut_____
7. Përshtatshmëria e legjislacionit në fuqi_____
8. Të tjera_____ (përcakto)_____

RUBRIKA II. ECURIA FINANCIARE E NDËRMARRJES DHE PRANIA E HUASË

P3. Në cilën monedhë e kryeni veprimtarinë e biznesit?
(përcakto përafërsisht përqindjen që zënë veprimet sipas monedhave të ndryshme në totalin e veprimtarisë së bizneseve):

1. Lekë ___%;
2. Euro ___%;
3. Usd ___%;
4. Tjetër _____ (përcakto) ___%.

P4. a) Si kanë ndryshuar shitjet e përgjithshme në 6 muajt e fundit? (rretho vetëm një):

1. Janë rritur
2. Janë ulur
3. Nuk kanë ndryshuar

b) Si prisni të ndryshojnë shitjet në 6 muajt e ardhshëm?
(rretho vetëm një):

1. Do të rriten
2. Do të ulen
3. Nuk do të ndryshojnë

P5. Sa rezultuan shitjet e përgjithshme në 6 muajt e fundit? (në Lekë të reja): _____

P6. a) Si ka ndryshuar rezultati financiar në 6 muajt e fundit?
(rretho vetëm një):

1. Është rritur
2. Është ulur
3. Nuk ka ndryshuar

b) Si prisni të ndryshojë në 6 muajt e ardhshëm?

(rretho vetëm një):

1. Do të rritet
2. Do të ulet
3. Nuk do të ndryshojë

P7. Sa ishte rezultati financiar i biznesit tuaj në 6 muajt e fundit, në lekë (të reja)? (zgjidh vetëm një alternativë)

1. Fitim: _____ lekë (të reja);
2. Humbje: _____ lekë (të reja).

P8. a) A e keni zgjeruar veprimtarinë/rritur investimet në 6 muajt e fundit? (rretho vetëm një):

1. Është zgjeruar
2. Është ngushtuar
3. Nuk ka ndryshuar

b) Si prisni të ndryshojë në 6 muajt e ardhshëm? (rretho vetëm një):

1. Do të zgjerohet
2. Do të ngushtohet
3. Nuk do të ndryshojë

P9. Si e keni financuar veprimtarinë e biznesit tuaj në 6 muajt e fundit? (mund të rrethohet më shumë se një alternativë):

1. Nga shitjet _____%
2. Nga rezervat e mbartura/rritja e kapitalit _____%
3. Hua _____%
4. Tjetër _____(përcakto) _____%

P10. A keni aktualisht hua për të paguar? (rretho vetëm një)

1. Po (nëse po, vazhdoni në pyetjen 11)
2. Jo (nëse jo, vazhdoni në pyetjen 25)

P11. Kur e keni marrë huanë? (mund të zgjidhet më shumë se një alternativë):

1. 6 muajt e fundit ____nr. i huave;
2. Vitin e fundit ____nr. i huave;
3. 1-5 vitet e fundit ____nr. i huave;
4. Para më shumë se 5 vitesh ____nr. i huave.

P12. Nga e keni marrë huanë (huatë) dhe me çfarë norme interesi (në %, vetëm për huanë më të madhe ekzistuese)? (mund të zgjidhet një ose më shumë alternativa):

		a	b	c	d
	Huamarrje në:	Nr. i huave	Norma e interesit (%)	Vlera e huasë	Monedha e huasë
1	Bankë				
2	Institucion financiar jobankë				
3	Person fizik				
4	Kompani të tjera				
5	Mall i papaguar				
6	Tjetër (specifik)_____				

P13. Cili është qëllimi i përdorimit të huasë? (mund të rrethohet më shumë se një alternativë):

1. Për të përballuar shpenzime korrente;
2. Për të shlyer një hua më të vjetër;
3. Për të kryer një investim afatgjatë;
4. Tjetër _____ (përcakto).

P14. Nëse keni marrë hua për të financuar veprimtarinë, si e konsideroni (referojuni huasë ekzistuese më të madhe të ndërmarrjes rretho vetëm një):

1. Të përshtatshme;
2. Do të doja të merrja më SHUMË;
3. Do të doja të merrja më PAK.

RUBRIKA III. STRUKTURA E HUASË

P15. Edhe sa kohë duhet për të shlyer të gjithë vlerën e huasë (afati maksimal - rretho vetëm një)?

1. Deri në 6 muaj;
2. 6-12 muaj;
3. 1-3 vjet;
4. 3-5 vjet;
5. Mbi 5 vjet.

P16. Si është përcaktuar norma e interesit të huasë më të madhe ekzistuese? (rretho vetëm një)

1. E pandryshueshme deri në fund të afatit;
2. Mund të ndryshojë çdo 3 muaj;
3. Mund të ndryshojë çdo 6 muaj;
4. Mund të ndryshojë çdo vit;
5. Tjetër _____ (përcakto).

P17. Sa shpesh e shlyeni huanë? (rretho vetëm një)

1. Çdo 1 muaj
2. Çdo 3 muaj
3. Çdo 6 muaj
4. Çdo 12 muaj
5. Tjetër

P18. Cili është kolaterali që keni vendosur për përfitimin e huasë? (mund të rrethohen më shumë se një alternativë).

1. Nuk ka ____nr. i huave;
2. Pasuri e paluajtshme ____nr. i huave;
3. Mjete financiare ____nr. i huave;
4. Dorëzani, garanci ____nr. i huave;
5. Të tjera _____ (përcakto) ____nr. i huave.

P19. Në rast të përdorimit të kolateralit, cila është vlera totale e tij në raport me totalin e huasë të kolateralizuar? (rretho vetëm një)

1. Deri në 50% e vlerës së huasë
2. 50-100% e vlerës së huasë
3. 100-120% e vlerës së huasë
4. Mbi 120% e vlerës së huasë

RUBRIKA IV. NGARKESA E HUASË

P20. Në 6 muajt e kaluar, sa keni paguar për huanë ndaj totalit të të ardhurave? (rretho vetëm një)

1. Deri në 20% të të ardhurave;
2. 20-50% të të ardhurave;
3. 50-80% të të ardhurave;
4. Mbi 80% të të ardhurave.

P21. Nëse ka ndryshuar shpenzimi për pagesën e huasë gjatë 6 muajve të kaluar, cili ka qenë shkaku?

	Mund të zgjidhen disa alternativa	Mund të zgjidhen disa alternativa
1. Nuk ka ndryshuar	<p>2. Është rritur, sepse:</p> <p>2.1 është rritur norma e interesit</p> <p>2.2 janë shtuar kërkesa të tjera nga huadhënësi</p> <p>2.3 kanë rënë të ardhurat nga veprimtaria e biznesit</p> <p>2.4 të tjera _____(përcakto);</p>	<p>3. Është ulur, sepse:</p> <p>3.1 është ulur norma e interesit</p> <p>3.2 është ulur vlera periodike e pagesës së huasë (p.sh. është ristrukturuar kredia)</p> <p>3.3 ka ndryshuar forma e pagesës së huasë, duke i shtyrë detyrimet periodike</p> <p>3.4 janë rritur të ardhurat nga veprimtaria e biznesit</p> <p>3.5 të tjera ____përcakto____</p>

P22. Nëse kosto e shërbimit të huasë është rritur, si keni vepruar për të përballuar këtë rritje? (mund të rrethohet më shumë se një alternativë)

1. Janë rritur çmimet e produkteve që iu shiten klientëve;
2. Është shitur një pjesë e veprimtarisë së ndërmarrjes;
3. Janë ulur shpenzimet e tjera;
4. Janë përdorur rezerva të ndryshme;
5. Është orientuar veprimtaria e ndërmarrjes drejt një fushë veprimi më fitimprurëse;
6. Tjetër_____ (përcakto).

P23. Si prisni të ndryshojë pagesa totale e këstit të huasë në 6 muajt e ardhshëm? (rretho vetëm një)?

1. Nuk do të ndryshojë;
2. Do të rriten;
3. Do të ulen;

P24. Si e vlerësoni në përgjithësi ngarkesën e borxhit?

1. E lartë;
2. Mesatare;
3. E ulët.

RUBRIKA V. MARRËDHËNIA ME BANKAT DHE PRITSHMËRITË PËR TË ARDHMEN

(REFERUAR EDHE BIZNESEVE JOHUAMARRËSE)

P25. A keni aplikuar për ndonjë formë financimi në gjashtëmujorin e fundit?

1. Po, kam aplikuar (vijo me tabelën):

1.1 Kërkesa ime është miratuar:		1.2 Kërkesa ime nuk është miratuar:	
1.1.1 është ristrukturuar huaja ekzistuese	1	1.2.1 Është në proces	4
1.1.2 kam marrë hua të re:		1.2.2. Nuk plotësoja kushtet e bankës	
1.1.2.1 deri në 75% të vlerës së kërkuar	2	1.2.2.1 Nuk kisha aftësi paguese	5
1.1.2.2 mbi 75% të vlerës së kërkuar	3	1.2.2.2 Projekti nuk ishte bindës	6
		1.2.2.3 Nuk kisha kolateral të mjaftueshëm	7
		1.2.2.4 Tjetër (specifiko)_____	8

2. Jo, nuk kam aplikuar sepse:

- 2.1. Nuk e kam të nevojshme për veprimtarinë që kryej
- 2.2. Më duket proces i vështirë
- 2.3. Mendoj që kërkesa ime nuk miratohet
- 2.4. E kam më të lehtë të marr hua nga burime alternative

P26. Si do të veproni nëse nuk financoheni nga banka?

Do të kërkoj në një bankë/institucion tjetër
do të shtyj në kohë planet për zgjerim të veprimtarisë
do të marr hua nga burime alternative

P27. Në përgjithësi, si do ta vlerësonit procesin e marrjes së një huaje nga bankat në vend, në këto 6 muajt e fundit (rretho vetëm një):

1. Shumë të thjeshtë;
2. Normal;
3. Të vështirë;
4. Shumë të vështirë;
5. Pothuaj të pamundur.

P28. Plotësoni elementët e mëposhtëm me shifrat nga 1 në 5, sipas vështirësisë që secili element paraqet për ndërmarrjen tuaj në përfitimin e një kredie bankare, ku 1- shkalla më e ulët e vështirësisë dhe 5- shkalla më e lartë e vështirësisë. (Plotëso secilën alternativë):

1. Paqartësi e kërkesave të bankës dhe procedura burokratike____
2. Kosto e lartë financiare për të plotësuar kërkesat e bankës____
3. Kushtet për garantimin e kredisë janë të paarsyeshme ____
4. Procedura e miratimit të kredisë nuk është transparente ____
5. Kredia në përgjithësi është e shtrenjtë____
6. Struktura e kredisë, nuk i përshtatet ciklit të veprimtarisë së biznesit____
7. Gjatë jetës së kredisë, kushtet e saj ndryshohen në mënyrë jotransparente nga banka____
8. Nuk ekziston fleksibiliteti i nevojshëm midis bankës dhe

kredimarrësit, për mënyrën e strukturimin dhe shlyerjen e kredisë____

9. Biznesi nuk arrin të plotësojë kërkesat normale të bankës për të marrë një kredi____.

P29. Sa është mundësia që ndërmarrja juaj të marrë një kredi bankare në 6 muajt e ardhshëm (rretho vetëm një)?

1. Nuk ka asnjë mundësi
2. Ka pak mundësi
3. Ka shumë mundësi
4. Është e sigurt

P30. Sa të rëndësishme do t'i konsideronit marrëdhëniet me bankat për ecurinë e veprimtarisë së kompanisë suaj (rretho vetëm një)?

1. Të domosdoshme;
2. Të rëndësishme;
3. Jo dhe aq të rëndësishme.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Dushku, Elona

Rezultatet e vërtimit të situatës financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve bujqësore në Shqipëri : qershor 2017 : material studimor / Elona Dushku, Kliti Ceca. – Tiranë : Banka e Shqipërisë, 2019

44 f. : me il. ; 21x15 cm.

ISBN 978-9928-262-21-9

I.Ceca, Kliti

1.Banka dhe veprimtaria bankare 2.Banka e Shqipërisë
3.Ekonomia bujqësore 4.Hua 5.Financa 6.Shqipëri

336.711(496.5)

338.43(496.5)

ISBN 978-9928-262-21-9



V-TUVVO.0SOONV>

www.bankofalbania.org

ISBN 978-9928-262-21-9



9 789928 262219 >